

Ringritja e Institutit Shkencor të Hidrokarbureve, MEI tryezë me grupet e interesit

2017-07-13 11:10:00



Në mjediset e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë u zhvillua takimi konsultativ me grupet e interesit në funksion të hartimit të akteve nënligjore për ringritjen e Institutit Shkencor të Hidrokarbureve. Aktet vijnë në zbatim të ndryshimeve të fundit në Ligjin Nr. 6/2017 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”.

Rikrijimi i Institutit Shkencor të Hidrokarbureve është konsideruar i domosdoshëm, pasi është ndërje në mënyrë thelbësore mungesa e tij, nga momenti kur ish-Qendra Kombëtare Shkencore e Hidrokarbureve u shkri në vitin 2006.

Gjatë takimit me grupet e interesit, Ministri i Energjisë dhe Industrisë Damian Gjajnuri theksoi se krijimi i Institutit do të mundësojë rritjen e kompetencës teknike dhe shkencore të palës shqiptare në industrinë hidrokarbure në përgjithësi dhe sidomos në aktivitetin e kërkimit dhe prodhimit, të cilat do të rrisin efektivitetin dhe eficientësinë e shfrytëzimit të vendburimeve hidrokarbure, që sikundër dihet janë shteruese, jo të rinovueshme, dhe strategjike për zhvillimin ekonomik të vendit, dhe jo vetëm.

Për këtë arsye do të bëhet edhe një riorientim i kompetencave dhe detyrave të AKBN që lidhen me aktivitetin e kërkimit dhe prodhimit të hidrokarbureve, e cila do të përqendrohet më shumë në monitorimin dhe ndjekjen e operacioneve hidrokarbure.

Instituti do të angazhohet në kryerjen e studimeve, të analizave, të konsulencës dhe të materialeve oponente, të monitorimit, në interes të organeve dhe të institucioneve shtetërore gjatë kryerjes së operacioneve hidrokarbure për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në territorin shqiptar, si dhe në sektorët e përpunimit, transportimit, depozitimit e tregtimit të lëndëve e produkteve hidrokarbure.

Instituti shkencor i hidrokarbureve do të administrojë të dhënat gjeologo-gjeofizike, teknike, ekonomike, duke realizuar ekskluzivitetin e pronësisë së shtetit mbi të dhënat që lidhen me veprimtaritë e kërkimit dhe të prodhimit të hidrokarbureve në Shqipëri, ato historike dhe të krijuar rishtas në sektorin e hidrokarbureve.

ISHH është parashikuar që të realizojë edhe studime fundamentale në fushat e gjeologjisë, gjeofizikes dhe teknologjisë së shpimit dhe nxjerrjes së naftës dhe shpimit të puseve; studime për gjendjen mjedisore dhe impaktet e industrisë së naftës në mjedis duke parashikuar dhe masat për minimizimin e këtyre impakteve, studime për projektme mekanike, sipërfaqësore të industrisë së naftës e gazit; studime mbi infrastrukturën e grumbullimit, ruajtjes, transportimit të naftës e gazit në rezervuarët mbi dhe nëntokësore, si dhe stokimin e gazit në rezervuarët natyrore.

Për përgatitjen e gjitha akteve të nevojshme nënligjore në zbatim të ligjit bazë, Ministria e Energjisë dhe Industrisë është duke u asistuar nga ana e konsulentit Roland Berger në kuadër të projektit “Për ngritjen e kapaciteteve për zhvillimet në përmasa të mëdha të infrastrukturës së gazit në Shqipëri”, të financuar nga Qeveria e Konfederatës Zvicerane.

